

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit “Master profesional” në “Psikologji shkollore”

Universiteti Privat “Albanian University”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. As. Dr. Mariana Sinani

Prof. As. Dr. Erika Melonashi

Qershor, 2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit “Master profesional” në “Psikologji shkollore”

Nr.	Tabela e të dhënave për programin e studimit	
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Shoqërore/ Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASH Nr. 202, datë 28.05.2013 ¹ Shkresë e MASR Nr. 6313/2 prot, datë 18.07.2018²
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	VBA Nr. 44, datë 19.05.2017 (ndryshuar me VBA Nr. 44/2, datë 02.02.2018)
5	Titulli i programit të studimit:	Master profesional në “Psikologji shkollore”
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
8	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
16	Numri i studentëve	33 studentë (Programi 60 ECTS për vitin 2018-2019)

¹ Programi është hapur me Urdhër Nr. 202, datë 28.05.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, dhe është ofruar me 90 kredite (ECTS), me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike.

² Programi është riorganizuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6, datë 28.02.2018 të UP “Albanian University”, për të cilin ka patur dakordësi nga MASR me shkresë nr. 6313/2 prot., datë 18.07.2018. Prej vitit akademik 2018-2019 ofrohet me 60 kredite (ECTS), me kohëzgjatje normale 1 vit akademik.

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit “Master profesional” në “Psikologji shkollore” dhe Universitetin Privat “Albanian University”

Universiteti Privat “Albanian University” është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 10.04.2004. Përgjatë viteve ky institucion i arsimit të lartë ka pësuar një sërë ndryshimesh si në emërtim dhe në strukturën e tij.

Së fundmi, me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Nr. 596, datë 21.12.2016 është miratuar Statuti dhe Organigrama e re në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (sipas Vendimit të Senatit Akademik Nr. 203, datë 28.09.2016 të Universitetit).

Gjithashtu, UP “Albanian University” ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me agjencinë Britanike të sigurimit të cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 90, datë 20.10.2017 dhe Universiteti është akredituar me kohëzgjatjen 2 vite, me afat vlefshmërie deri në 19.10.2019. Aktualisht, UP “Albanian University” është në proces vlerësimi në kuadër të akreditimit periodik institucional.

Sipas strukturës së miratuar, UP “Albanian university” përbëhet nga tre Fakultete dhe dhjetë Departamente.

➤ **Fakulteti i Shkencave Shoqërore**

1. Departamenti i Shkencave Politiko - Administrative
2. **Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme**
3. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes
4. Departamenti i Shkencave Juridike

➤ **Fakulteti i Shkencave Mjekësore**

1. Departamenti i Stomatologjisë
2. Departamenti i Farmacisë
3. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë

➤ **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike**

1. Departamenti i Arkitekturës
2. Departamenti i Shkencave Ekonomike
3. Departamenti i Inxhinierive

Për vitin akademik 2018-2019, UP “Albanian University” ofron programe studimi në tre cikle, përkatësisht: 16 programe studimi të ciklit të parë “Bachelor”; 22 programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” dhe “Master i shkencave”; 6 programe studimi të ciklit të tretë “Studime të Doktoratës” dhe “Studime Specializues Afatgjata”.

Programi i studimit “Master profesional” në “Psikologji shkollore” ofrohet nga **Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në Fakultetin e Shkencave Shoqërore**. Programi është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 202, datë 28.05.2013, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 465, datë 03.05.2013, me kohëzgjatje 1.5 vite akademike dhe 90 kredite (ECTS).

Ky program është vlerësuar në kuadër të akreditimit të parë dhe është akredituar (*citojmë*) “**vetëm për brezat e studentëve aktualisht të regjistruar dhe që ndjekin studimet në këtë program, përfshirë ata të regjistruar në vitin akademik 2017-2018, deri në diplomimin e tyre**” me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 44, datë 19.05.2017 (*ndryshuar me VBA Nr. 44/2, date 02.02.2018*).

Në shtojcën e VBA Nr. 44, datë 19.05.2017, ka patur dhe këto **rekomandime**:

1. Të plotësohet regjistri i arritjeve me vlerësimet negative të studentëve;
2. Të shtohet numri i titujve në Bibliotekë lidhur me psikologjinë dhe të përmirësohet infrastruktura;

3. Të mundësohet informimi i studentëve, stafit dhe publikut lidhur me sigurimin e cilësisë.

Me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6, datë 28.02.2018 të Universitetit, programi i studimit “**Master profesional**” në “**Psikologji shkollore**” është riorganizuar në **60 kredite (ECTS)**, me kohëzgjatje **1 vit akademik**, konform kërkesave ligjore në fuqi për organizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”. Ky riorganizim është dakordësuar nga ana e Ministrisë me shkresë të MASR Nr. 6313/2 prot, datë 18.07.2018.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm Periodik (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Psikologji shkollore”, ofruar nga UP “Albanian University”. Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitave në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. As. Dr. Mariana Sinani dhe Prof. As. Dr. Erika Melonashi si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Emisa Isufaj dhe gjatë vizitës në Institucion nga Znj. Majlinda Demirneli.

Universiteti Privat “Albanian University” është njohur me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 29.05.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 10/23 Prot., datë 29.05.2019. UP “Albanian University” përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 338/1 Prot., datë 06.06.2019 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertët e Vlerësimit u njohën me komentet dhe vendosën të japin argumentat e mëposhtme dhe të bëjnë një reflektim si më poshtë:


1. Konstatim i GVJ: analiza 1.fq 5: Rekomandimet e lëna gjatë procesit të akreditimit janë të përmbushura mjaftueshmërisht

Përgjigjja e IAL: Lutemi, të saktësohet termi «mjaftueshmërisht» sipas sistemit të vlerësimit të përcaktuar në manualin për «Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit»

Konstatimi është reflektuar në Draft RVJ pas shqyrtimit të Manualit të ASCAL.

2. Konstatim i GVJ: kriteri 5 fq 20: Raporti i GVB nuk ka paraqitur të dhëna mbi kostot e realizimit të programit.

Përgjigjja e IAL: Informacioni mbi kostot e realizimit të programit është paraqitur në RVB sipas formatit që kërkohet. Gjithashtu, në evidencën bashkëngjitur gjeni të dhënat e kërkuara. (Evidencë nr. 1)



GVJ i qëndron mendimit të dhënë në Draft RVJ se Raporti i GVB nuk ka paraqitur të dhëna mbi kostot e realizimit të programit me argumentimin se të dhënat e paraqitura në RVB si dhe në Evidencën 1 janë mbi të ardhurat dhe jo kostot e realizimit të programit.

3. Konstatim i GVJ: kriteri 6 fq 24 Përpyjekjet për përmirësimin e programeve të studimit ende nuk janë fokusuar tek kompetencat specifike profesionale që duhet të njohë dhe aplikojë studenti.

Përgjigjja e IAL: Rishikimi i syllabuseve të lëndëve në fillim të çdo viti akademik/semestri, mundëson që departamenti të ketë gjithmonë vëmendjen që rezultatet e të nxëniet dhe aftësitë e fituara në fund të çdo lënde të jenë të lidhura me kompetencat specifike profesionale të psikologut shkollorë, në përputhje edhe me rregulloren e programit të studimit neni 4, fq. 1. (referojuni evidencës nr. 1.1)


GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron mendimin të dhënë në Draft RVJ me argumentimin si më poshtë: Mungon evidenca se procesi i rishikimit të syllabuseve ka rezultuar në një fokus më të madh mbi kompetencat specifike profesionale. Evidenca 1.1 e paraqitur në mbështetje është thjesht Rregullorja e Programit të studimit.

4. Konstatim i GVJ: fq 21 Kriteri 5: Gjatë vizitës në institucion nuk morëm një përgjigje as gojore dhe as të dokumentuar për një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas mbarimit të studimeve.

Përgjigjja e IAL: Institucioni disponon statistika të punësimit të studentëve të cilat i ka dokumentuar në raport si dhe gjatë vizitës në Institucion vlerësuesve iu mundësuan statistika më të detajuara duke përfshirë edhe institucionet në të cilat janë të punësuar studentët e këtij programi studimi. (Këtë të dhënë e gjeni në shërbimin: Dokumentacioni i kërkuar gjatë vizitës në AU për programin e studimit Mp. në Psikologji Shkollore, evidenca nr. 12.1 dhe 12.2)

GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim, por i qëndron mendimin të dhënë në Draft RVJ me argumentimin si më poshtë. Gjatë vizitës në institucion u vu në dispozicion një listë (dhe jo databazë të dhënash) mbi punësimin e studentëve. Mund të konstatohet lehtësisht se në fakt Evidenca 12 paraqet llojin e punësimit për studentët aktualë, jo ata pas mbarimit të studimeve, çka është e dhënë irrelevante për kriterin në fjalë. Nga ana tjetër Evidenca 12.1. është thjesht një listë e shkurtër prej 11 studentësh ndërkohë numri total i të diplomuarve është 87 (Regjistri i Diplomave, faq.35 RVJ). Pra në konkluzion kjo evidencë e paraqitur nuk mund të konsiderohet si bazë të dhënash.

5. Konstatim i GVJ: fq 40 kriteri 10 Nuk është “pjekur” ende, mendimi për një “sistem mentorësh” që do të udheheqin praktikën profesionale në institucionet ku studentët përmbushin këtë pjesë të programit dhe ku repertori sjellor i studentit rritet deri në nivelin e kompetencave profesionale. Marrëveshjet janë kryesisht me aktorë lokal dhe shtrihen në nivel kombëtar; përpjekjet për marrëveshje me institucione ndërkombëtare janë ende modeste.




Përgjigjja e IAL: Marrëveshjet për programin Master Profesional në Psikologji Shkollore janë në kuader të realizimit të praktikës mësimore. Në këtë perspektive, marrëveshja me DAR është një lehtësim dhe mundësi që studentët të shkojnë nëpër shkolla dhe të njihen me pozicionin dhe detyrat që kanë psikologët e shkollave. Në këtë program është caktuar një mentor që monitoron, drejton dhe orienton studentet në realizimin e praktikës dhe në të ardhmen do të shikohet mundësia e ngritjes së një “sistemi mentorësh”.

GVJ i qëndron mendimit të shprehur në Draft RVJ, se mungon sistemi i mentorëve (fakt që mbështetet edhe nga kthimi i përgjigjes së institucionit). Konstatohet se përgjigjja e institucionit është një sqarim i konstatimit të GVJ por jo kontestim.

6. Konstatimi i GVJ: fq 34 kriteri 9 Studimi i tregut të punës realizuar nga Institucioni në mënyrë specifike për Programin “Master profesional” në “Psikologji shkollore” raporton 64.5% e studentëve janë punësuar në përputhje me Diplomën. Ndërkohë gjatë vizitave në institucion u vërejt se zyra e Alumni nuk disponon shifra të sakta mbi numrin total të të punësuarve .Vihet në pikëpyetje mënyra sesi janë nxjerrë përqindjet në dokumentin specifik si dhe besueshmëria e tyre.

Përgjigjja e IAL: Në lidhje me dokumentin mbi studimin e tregut të punës, theksojmë se ka qënë një lapsus nga njësia bazë mbi përqindjen e të dhënave. Ashtu siç u sqarua edhe më sipër në pikën 4, Institucioni disponon statistika të sakta të punësimit të studentëve të cilat i ka dokumentuar në raport si dhe gjatë vizitës në Institucion vlerësuesve iu mundësuan statistika më të detajuara duke përfshirë edhe institucionet në të cilat janë të punësuar studentët e këtij programi studimi. (Këtë të dhënë e gjeni në shërbimin: Dokumentacioni i kërkuar gjatë vizitës në AU për programin e studimit Mp. në Psikologji Shkollore, evidenca nr. 12.1 dhe 12.2).

GVJ i qëndron mendimin të dhënë në Draft-RVJ me argumentimin e dhënë në pikën 4, përfshi edhe evidencat që riparaqiten në mbështetje 12.1. dhe 12.2. (Mund të konstatohet lehtësisht se në fakt Evidenca 12 paraqet llojin e punësimit për studentët aktualë, jo ata pas mbarimit të studimeve, çka është e dhënë irrelevante për kriterin në fjalë. Nga ana tjetër Evidenca 12.1. është thjesht një listë e shkurtër prej 11 studentësh ndërkohë numri total i të diplomuarve është 87 (Regjistri i Diplomave, faq. 35 RVJ). Pra në konkluzion kjo evidencë e paraqitur nuk mund të konsiderohet si bazë të dhënash. Gjithashtu vetë institucioni konstaton se ka problematika edhe në raportimin e statistikave të sakta në dokumenta zyrtare si studimi i tregut të punës.



ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

Në bazë të vendimit Nr. 44, datë 19.05.2017, Bordi i Akreditimit, për Programin “Master profesional” në “Psikologji shkollore” rekomandoi si më poshtë vijon:

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit:

- a) Të plotësohet rregjistri i arritjeve me vlerësimet negative të studentëve;
 - b) Të shtohet numri i titujve në Bibliotekë lidhur me psikologjinë dhe të përmirësohet infrastruktura;
 - c) Të mundësohet informimi i studentëve, stafit dhe publikut lidhur me sigurimin e cilësisë
- a) Për rekomandimin mbi plotësimin e regjistrit të arritjeve me vlerësimet negative të studentëve, na rezulton që institucioni **ka përmbushur pjesërisht këtë rekomandim**. Regjistri mirëmbahet konform Rregullores së Sekretarisë Mësimore e cila sqaron se në rastin kur një rezultat është negativ vendi mbetet bosh, deri në momentin që studenti arrin të marrë një rezultat pozitiv. Institucioni argumenton se referuar Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor Nr. 80/2015 përkatësisht nenit 101, pika 2, thuhet se regjistrat shpërndahen nga ministria përgjegjëse për arsimin, kundrejt tarifës përkatëse që përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, Institucioni, është në pritje të formatit të unifikuar të regjistrave të arritjeve akademike, gjë që, do të shmangë pjesën e ndryshimit të regjistrave disa herë, duke krijuar në këtë mënyrë konfuzionin e të pasurit disa regjistra për çdo program studimi përfshirë këtu edhe programin “Master profesional” në “Psikologji shkollore”.
- b) Për rekomandimin në lidhje me shtimin e numrit të titujve të librave të psikologjisë së përgjithshme por dhe të disiplinave specifike të psikologjisë, na rezulton që institucioni **ka përmbushur kryesisht këtë rekomandim** duke bërë blerjen e disa titujve Psikologjikë në funksion të programit (12 tituj autorësi e huaj dhe shqiptare), tituj, të cilët gjënden në mjediset e bibliotekës së institucionit. Gjithsesi titujt nuk janë të gjithë në funksion të programit Master Profesional Psikologji Shkollore, por në përgjithësi në funksion të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme. Gjithashtu përsa i përket përmirësimit të infrastrukturës, vërehet se salla e bibliotekës është e përshtatshme për të plotësuar nevojat e studentëve, duke kryer njëkohësisht funksionin e sallës së studimit.
- c) Për rekomandimin rreth informimit të studentëve, stafit dhe publikut lidhur me sigurimin e cilësisë, na rezulton që institucioni konkretisht {Departamenti/Njësia e sigurimit të cilësisë/Zyra e Karrierës, stafi akademik i brendshëm} **ka përmbushur rekomandimin**, duke dhënë vëmendjen e mjaftueshme rreth informimit në kohën e cilësinë e duhur të studentëve dhe të interesuarve rreth programit në fjalë. Institucioni periodikisht prodhon një Raport që publikohet në faqen eeb të institucionit. Të dhënat e mbledhura nga realizimi i fokus grupeve dhe pyetësorëve me studentët iu komunikohen të interesuarve dhe aktorëve.

Përfundimisht, konfirmojmë se rekomandimi i tretë është përmbushur. Ndërkohë rekomandimi i parë është përmbushur pjesërisht ndërsa rekomandimi i dytë është përmbushur kryesisht.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore



Të dhëna për programin e studimit “Master profesional” në “Psikologji shkollore”

Programi i studimit në fjalë, inicohet, përmbushet dhe monitorohet nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Shoqërore në Institucionin e Arsimit të Lartë “Albanian University”. Programi është licencuar nga MASH me Urdhër Nr. 202, datë 28.05.2013 dhe akredituar me Vendimin nr. 44, datë 19.05. 2017 “Për akreditimin e parë të programit të ciklit të dytë Master Profesional Psikologji shkollore”, Ndryshuar me VBA Nr. 44/2, datë 02.02.2018, akredituar vetëm për brezat e studentëve aktualisht të rregjistruar dhe që ndjekin studimet përshirë vitin akademik 2017-2018 deri në diplomim.


Të diplomuarit në këtë program, të cilët gjithashtu kanë kryer ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në “Psikologji” (por jo fusha të tjera të përafërta), kanë të drejtë të anëtarësohen në Urdhërin e Psikologut, duke aplikuar për licencën përkatëse, dhe potencialisht pritet të ushtrjnë profesionin e psikologut në institucione shkollore, publike dhe private, si dhe në institucione të tjera edukimi. Ky program nuk ofron mundësi për ndjekje të studimeve doktorale.

Organigrama e Institucionit i jep mundësi që të përmbushë qëllimet dhe misionin për të cilin është ngritur Programi. **Objektivat e këtij programi studimi synojnë të përgatisin psikologun shkollor, përmes zgjerimit dhe thellimit të njohurive me karakter teorik por edhe kompetencave profesionale në drejtimin përkatës. [Referuar RVB].** Gjithashtu, *Misioni, Objektivat e Përgjithshme dhe Objektivat Specifikë* përfshihen dhe në **Rregulloren e Programit të Studimit**. Programi shtrihet në një vit akademik dhe përmbushet përmes orëve në auditor, leksion/seminarë/praktikë profesionale në përputhje me kornizën ligjore. Programi është ngritur konform skemës: disiplina të formimit të përgjithshëm, disiplina të formimit karakterizues, disiplina integruese dhe aftësimi në praktikat profesionale në institucione shkollore. Programi përmbyllet me mbrojtjen e temës së diplomës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit; Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës GVJ konstaton se: Programi “Master profesional” në “Psikologji shkollore” është në përmbushje: <ul style="list-style-type: none">• të qëllimit dhe misionit të institucionit.• të nevojave të tregut të punës. Gjithashtu bazuar në Rregulloren e Programit të studimit, GVJ vlerëson se: Programi “Master profesional” në “Psikologji shkollore” orientohet nga tendencat e zhvillimit socio-ekonomik të shoqërisë dhe ndjek dinamikat sociale. [Evidenca 1.1. Rregullore e Programit të Studimit]. GVJ konstatoi përpjekjet e institucionit për kryerjen e një studimi të tregut të punës, e cila pavarësisht mangësive, jep disa indikacione të përgjithshme në këtë drejtim. [Evidence 1.3. Analiza e tregut të punës] Sikundër është shprehur në Statut por edhe gjatë vizitës në institucion u konstatua se Programi “Master profesional” në “Psikologji shkollore”, dëshmon vullnetin e institucionit për ruajtjen e konsolidimin e vlerave kulturore të kombit dhe përmbushjen e ambicies së institucionit. [Evidenca 1.2. Statuti i AU]

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Programi i studimit është përshtatur me kriteret e përcaktuara në strategjinë për zhvillim të institucionit, specifikuat me pikën “Mësimdhënia, kurrikula, mësimnxënia”.
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	GVJ konstaton se Programi i studimit është konform me ligjin e Arsimit të Lartë, aktet nënligjore, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit. “Masteri Profesional” në “Psikologji Shkollore” klasifikohet në Nivelin 7 sipas Kornizës Shqiptare të kualifikimeve, dhe me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6, datë 28.02.2018 të Universitetit, është riorganizuar në 60 kredite (ECTS), me kohëzgjatje 1 vit akademik , konform kërkesave ligjore në fuqi për organizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”.
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	GVJ vlerëson se në përputhje me Strategjinë për Zhvillim Institucional [Evidenca 1.4. Strategjia për Zhvillim Institucional 2017-2022] Institucioni ka në fokus përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të rritur cilësinë e tij. Plani strategjik i institucionit për përmirësimin e cilësisë reflektohet si në raportet vjetore të NJSBC [Evidenca 3.6] ashtu edhe më ngushtë në nivel departamenti [Evidenca H1. Strategjia e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme dhe Evidenca 6.3. Raporti vjetor] Rezulton se Institucioni nxit dhe synon kombinimin e dijes teorike të programit me aplikimin praktik, duke orientuar studentët drejt aftësisë për të identifikuar dhe trajtuar dukuritë/problematikat në terrenin shkollos.
Konkluzionet e vlerësimit: GVJ konstaton se Programi është ndërtuar, funksionon dhe përmbushet në përputhje të plotë me kornizën ligjore të Republikës së Shqipërisë. Programi është në frymën e vetëdijes kombëtare dhe kulturës sonë. Programi ka identifikuar nevojën për psikologun shkollos si nevojë aktuale e tregut shqiptar.	



2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Fakulteti i Shkencave Shoqërore është një nga tre fakultetet e IAL UP "Albanian University". Fakulteti ka në përbërjen e tij 4 departamente përfshi: **Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, Departamenti i Shkencave Juridike dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes**. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme në përfundim të të cilave përfitohet diplomë sipas ciklit përkatës. Fakulteti e përmbush qëllimin dhe objektivat strategjike përmes strukturave institucionale, dhe ka në përbërje organet drejtuese, njësitë bazë mësimore e shkencore, mbështetur nga sekretaria, administrata etj. [Evidenca 2.4. Rregullore e Përgjithshme e AU]

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, është një nga departamentet e këtij fakulteti, i cili specifikisht mbulon programin në fjalë.

Të dhënat për organigramën e AU, bëhen publike dhe në ëcsitin e institucionit [Evidenca: Link 1: <https://albanianuniversity.edu.al/sq/struktura-institucionale/>; Evidenca Link 2: <https://albanianuniversity.edu.al/sq/organizimi-institucional-2/>]. Baza e të dhënave si dhe e stafëve akademike dhe administratës së Universitetit gjendet e dokumentuar dhe rifreskohet çdo fillim viti akademik nga Zyra e Burimeve Njerëzore [Vizita në institucion; Minutat], e cila funksionon si hallkë ndërlidhëse midis Fakulteteve, Departamenteve dhe të gjitha njësite të tjera bazë që funksionojnë në Universitet referuar Statusit dhe Rregullores së Institucionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Shkencave Shoqërore organizon dhe drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta apo të ndërthurura. Fakulteti ofron programe studimi të llojeve dhe niveleve të ndryshme në përfundim të të cilave përfitohet diplomë sipas ciklit përkatës. Fakulteti përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore shkencore dhe nga administrata. Autoritetet drejtuese janë Dekani dhe Përgjegjësit e departamenteve.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka në përbërje katër departamente:

- **Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme**
- Departamenti i Shkencave Politike-Administrative
- Departamenti i Shkencave Juridike
- Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes

Personeli Akademik përbëhet nga profesorë, lektorë dhe asistent-lektorë me kontratë me kohë të plotë, si dhe personeli akademik i ftuar, ku përfshihen profesorët dhe lektorët. Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në kontratën e punës [Evidencë 1.2: Statuti, Neni 33, 36, 38, fq. 22-24].

Për vitin akademik 2018-2019: në Fakultetin e Shkencave Shoqërore angazhohen **38 PAE** dhe **73 PAK** si dhe 26 personel administrativ. Njësitë bazë të këtij fakulteti plotësojnë kriterin ligjor për numrin dhe kualifikimin e personelit akademik efektiv, sikurse konstatohet në analizën më poshtë [Tabelat 1; 1.1; 1.2; 1.3; 1.4 Aneksel]:

- Në Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme, angazhohen 10 PAE (1 Prof. As.; 2 Dr.; 4 Msc.), 19 PAK (1 Prof. Dr.; 2 Prof. As.; 12 Dr.; 4 Msc.).

- Në Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes, angazhohen 10 PAE (2 Prof. As.; 8 Dr.), 14 PAK (1 Akademik i Asociuar; 2 Prof. Dr.; 3 Prof. As.; 6 Dr.; 3 Msc).
- Në Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative, angazhohen 8 PAE (1 Prof. Dr.; 6 Dr.; 1 Msc), 20 PAK (1 Prof. Dr.; 3 Prof. As.; 9 Dr.; 7 Msc.).
- Në Departamentin e Shkencave Juridike, angazhohen 10 PAE (2 PhD., 3 Dr.; 5 Msc.), 20 PAK (2 Prof. Dr.; 2 Prof. As.; 1 PhD., 6 Dr.; 1 Magjister, 8 Msc.)

Për këtë program studimi nuk ka pasur koordinime me njësi të tjera. Të gjitha lëndët e kësaj kurrikule mbulohen nga stafi akademik i anagazhuar vetëm në Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme.

Tregues të matshëm:

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Për vitin akademik 2018-2019: raporti personel efektiv dhe personel me kontratë në nivel njësie bazë në Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme, është 10/19 (PAE/PAK). Kualifikimi për personelin akademik të Departamentit, sikurse analizohet më sipër, është:

- Personel Akademik Efektiv (PAE): 1 Prof. As.; 2 Dr.; 4 Msc. (nga të cilët 2 janë në proces të studimeve të doktoratës);
- Personel Akademik me Kontratë (PAK): 1 Prof. Dr.; 2 Prof. As.; 12 Dr.; 4 Msc.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>UP “Albanian University” funksionon në mënyrë efektive për arritjen e misionit të tij që janë: kurrikula cilësore, të balancuara, cilësi në proceset e mësimdhënies, dhe arritje të objektivave të formuluar në Statut dhe Rregullore deri në diplomimin e studentëve, referuar programeve specifike.</p> <p>Konfirmojmë që UP “Albanian University” ka në përbërjen e tij 3 Fakultete, Fakulteti i Shkencave Shoqërore në të cilin bën pjesë edhe Departamenti i Psikologjisë. Fakultetin e Shkencave Mjekësore si edhe Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.</p> <p>Konfirmojmë që Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka në përbërje të tij këto njësi bazë: Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes, Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme, Departamentin i Shkencave Politiko-Administrative dhe Departamentin e Shkencave Juridike. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, që ofron këtë program studimi, ka në përbërje 10 PAE, nga të cilët 1 Prof. As. dhe 2 Dr., pra plotësohet kriteri ligjor për numrin dhe kualifikimin e personelit akademik efektiv i njësisë bazë.</p>
---	---


Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Nga Vizita në institucion dhe dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se të gjitha njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, operojnë me një rregullore të veçantë, në të cilat përcaktohen qartësisht objektivat dhe instrumentet përmes të cilave përmbushen ose jo objektivat respektive [Evidenca 2.4. Rregullore e Përgjithshme e AU dhe Evidenca 2.3. Rregullore e Departamentit të Psikologjisë]</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe kontakteve me stafin akademik, GVJ konstatoi se procedura e rekrutimit të stafit është transparente (njoftime të publikuara online) si dhe lejon përfshirjen e njësisë bazë në proces, në përputhje me atë cka shprehet në Rregullore [Evidenca 2.4. Rregullore e Përgjithshme e AU]</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ konstaton se organizimi i institucionit, Fakultetit dhe Departamentit përkatës rezulton në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi

Njësitë bazë operojnë bazuar mbi një rregullore të vecantë, dhe organizimi hierarkik si dhe përbërja e personeli akademik të njësisë bazë janë në përputhje me kornizën ligjore.



3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Shpërndarja e ngarkesës rezulton brenda normës së lejuar [Tabela 1.5 Aneksë]. Rekrutimi behet konform Rregullores së Brendshme të Institucionit e cila derivon nga Ligji për Arsimin e Lartë [Evidenca 2.4. Rregullore e Përgjithshme e AU]. Stafit akademik i brendshëm dhe i jashtëm i përket kategorisë Dr. ose Prof. As. Dr, dhe shfaqet në raportin SPAE/1PAK. Antarët e stafit akademik dhe administrativ janë më kontratë të rregullt pune dhe nuk vërehen ndërprerje të kontratave, apo edhe kalime të lëndëve nga një pedagog në tjetrin.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat.

Për vitin akademik 2018-2019: Në nivel programi studimi për “Master profesional” në “Psikologji shkollore” janë angazhuar 5 anëtarë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 1 anëtar si personel akademik me kontratë (PAK) si dhe 7 anëtarë si Personel Administrativ (PA) [Tabela 3 Aneksë]. Siç shihet, raporti mes PAE dhe PAK është 5:1. Personeli akademik mban gradën Dr. dhe në një rast Prof. Asoc. Dr.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit

Programi i Studimit nuk ka këshill shkencor - por ka një koordinator të programit me titullin Prof. As. Dr.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Për vitin akademik 2018-2019: Në nivel programi studimi për “Master profesional” në “Psikologji shkollore” angazhohen nëtotal 6 personel akademik.

Kualifikimi i këtij personeli [Tabela 3 Aneksë; CV]:

- Personel Akademik Efektiv (PAE): 1 Prof. As.; 4 Dr.;
- Personel Akademik me Kontratë (PAK): 1 Dr.

Rezulton se stafi që jep mësim në programin në fjalë si ai efektiv dhe ai me kontratë është me tituj dhe grada shkencore. Ajo që mund të thuhet për stafin është qëndrueshmëria, nuk ka largime, ndërprerjetë kontratave, apo edhe kalime të lëndëve nga një pedagog në tjetrin.

- Të dhënat sipas seksit

Rezulton se nga i gjithë stafi akademik (PAE &PAK) dhe ai administrativ raporti sipas seksit në programin e studimit është 4 femra dhe 2 meshkuj. Raporti në nivel departamenti është 19 femra dhe 10 meshkuj.

- Të dhëna sipas moshës së personelit

Në përgjithësi stafi akademik efektiv (PAE) ka një moshë të re dhe i ndarë sipas grupimit 30-45 vjeç janë 5 vetë staf akademik (4 PAE dhe 1 PAK) dhe vetëm 1 në grup moshën 66-68 vjeç. Përsa i përket personelit ndihmës akademik grupmosha përkatëse është 25-35 vjeç (7 vetë).

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Konfirmojmë se të gjithë antarët e stafit akademik dhe administrativ janë më kontratë të rregullt pune me afat të caktuar ose pa afat, ku përshkruhen të drejtat dhe detyrat e stafit akademik [Vizita në institucion, Minutat, Evidenca 3.1a/b].

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmës ndonëse jo në të gjitha rastet me studime të nivelit të dytë pra me studime MP ose MSH, rezulton se është i përgatitur dhe punon me seriozitet.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion


Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre; Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Nga bashkëbisedimi me stafin akademik dhe njësitë e ngarkuara për mbarëvajtje të programit, konstatuam që: ka mjaftueshmërisht përgjegjësi në lidhje me realizimin e programit. Konstatojmë se identifikuam standarde të nevojshme dhe kompetencë në punën e tyre në realizimin e misionit, objektivave dhe mbi të gjitha realizimin e një mësimdhënieje cilësore. Dukshëm bie në sy që Njësitë bazë Brenda institucionit përfshihen qëllimshëm dhe seriozisht në rekrutimin e personelit akademik të nevojshëm, në respekt të procedurave të përcaktuara në rregulloren e institucionit dhe të njësisë, duke insistuar në formimin akademik adekuat të pedagogëve të cilët lipset të përmbushin programin.
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve; Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Bashkëbisedimi i qëllimtë përgjatë vizitës në institucion na çon të besojmë se stafi akademik funksion si trupë profesionale, të cilët rezonojnë në përpjekjet e tyre për cilësi dhe riformulim të herëpashershëm të silabuseve pa prekur bërthamën e tyre. Riformulimet e nevojshme të kurrikulës ndjekin rrugën institucionale dhe pasi pihen në aspektin profesional behen ndryshime të arsyeshme. Ngarkesa mësimore rezulton e ballancuar në pikëpamjen e oreve për çdo syllabus por dhe në pikëpamjen e ekspertizes që secili pedagog zotëron.
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>GVJ konstatoi se rekrutimi bëhet në rrugë ligjore dhe të hapur, referuar rregullores së brendëshme dhe kornizës ligjore [Vizita në Institucion, Minutat gjatë takimeve, Evidenca 2.4. Rregullore e Përgjithshme e AU].</p> <p>Stafi i brendshëm i angazhuar në përmbushje të programit “Master profesional” në “Psikologji shkollore” është në masën 70% është i punësuar në kohë të plotë [Vizita në Institucion, Tabela 3].</p> <p>GVJ konstatoi se njoftimet për vendet vakante publikohen në faqen zyrtare ëb-site të institucionit. Dosjet e pedagogëve ruhen në Zyren e Burimeve Njerëzore dhe gjithashtu Departamenti ruan dosje për arrijtjet profesionale të stafit.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve përëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjës për Programin “Master profesional” në “Psikologji shkollore” është koordinatori i Programit të Studimit, i cili mban titullin Prof. Asoc. Dr.</p> <p>Titullarët e lëndëve që zhvillohen në programin “Master profesional” në “Psikologji shkollore” janë minimalisht me titujt Dr., një prej tyre me Prof.As.Dr. dhe kanë rreth ose më shumë se 5 vjet eksperiencë pune në mësimdhënie [Silabuse; CV].</p> <p>Rektori, dekani, përgjegjësi i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithëshme dhe të gjithë pedagogët e angazhuar në përmbushje të këtij programi janë staf i brendshëm.</p> <p>Praktika profesionale në këtë program studimi mbikqyret nga koordinatori i programit dhe zhvillohet në grup dhe jo individualisht.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Studentët udhëhiqen nga stafi i pedagogëve në përmbushjen e tezës përfundimtare, por dhe përgjatë detyrave të kursit. Këtë fakt e konfirmuan studentët gjatë bashkebisedimit të planifikuar në agjende. Udhëheqësit kanë gradën Dr. Në këtë program rikujtojmë që stafi është i gjithi me titullin Dr. Stafi nuk udhëheq më shumë se 5 studentë, referuar rregullores së brendëshme të institucionit dhe kornizës ligjore në fuqi.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Përgjithësisht, fusha e ekspertizës së pedagogut rezonon me fushën ku studenti fokusohet. Pedagogët që realizojnë procesin e udhëheqjes së tezave kanë mjaftueshmërisht formim akademik dhe metodologjik për të mbështetur studentët në proceset kërkimore.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi nuk ka detyrimin për të zhvilluar orë laboratorike. Në funksion të përmbushjes së objektivave të programit “Master profesional” në ‘Psikologji shkollore’, të gjitha njësitë institucionale dhe zyrat, janë në mbështetje dhe angazhohen për të ndihmuar dhe lehtësuar çdo student deri në fazën e diplomimit. Dukshëm konstatuam seriozitet dhe efikasitet të stafit.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Stafi angazhohet të realizojë ngarkesën e programit në respekt të kontratës individuale dhe të detyrimeve konform rregullores së programit. Nuk konstatuam mbingarkesë të stafit, çka mund të cënonte cilësinë e përmbushjes së objektivave. Ngarkesa individuale e çdo pedagogu ishte e përthyer në orë mësimore për javë/semeseter.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Zyra e personelit disponon të dhëna individuale/të hollësishme/ të sistemuara për çdo pedagog të brendshëm/jashtëm, ku gjenden titujt/gradat si dhe kontrata individuale e punës.</p> <p>Institucioni identifikon, shpall dhe ndjek gjithë procesin e rekrutimit të stafit në respekt të ligjit, rregulloreve dhe në respekt të specifikave të programit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>GVJ konstaton se Institucioni identifikon, shpall dhe ndjek gjithë procesin e rekrutimit të stafit në respekt të ligjit, rregulloreve dhe në respekt të specifikave të programit.</p> <p>Nuk konstatuam mbingarkesë të stafit, çka mund të cënonte cilësinë e përmbushjes së objektivave. Ky fakt garanton qëndrueshmëri të programit.</p> <p>Ngarkesa individuale e çdo pedagogu ishte e përthyer në orë mësimore për javë/semeseter, çka e bënte lehtësisht të kontrolluar dhe të balancuar përgjegjësi individuale.</p>	



4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Pjesa përshkrimore

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme i cili ofron programin “Master profesional” në “Psikologji shkollore” ndodhet në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, në Blv. Zogu I. Godinë është e ristrukturuar por jo e rikonceptuar. Gjithsesi, është mjaftueshmërisht mirë, për të kryer funksionin përkatës. Infrastruktura është e përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore. Auditorët janë pajisur me kompjuter, video-projektor, sistem kondicionimi. Shërbimi i fotokopjes, salla e konferencave, biblioteka ofrojnë kushte të përshtatshme për studentët. Nyjet sanitare janë mjaftueshëm në numër për të mbuluar nevojat e studentëve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit (Tabela 7 Aneksë)

Në Universitet gjenden mjedise të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor, që nga:

- Sallat për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Laboratorë informatike
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Korridore/holl'e
- Mjedise shërbimi përtë tretë
- Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore
- Mjedise shlodhëse (kafeteri/fast food)
- Nyje hidrosanitare për studentët

Këto të dhëna jepen me detaje në Tabelën 7 në Aneksë dhe mbështeten nga dokumentacioni përkatës (planimetritë) (Evidencë 4.1).

Mjediset për stafin:

Mjediset për stafin:
Zyra për Dekanin
Zyra për sekretarinë mësimore
Zyra për departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme
Zyra për personelin akademik
Zyrë për financën
Zyrë për Njësinë e SBC

Salla për mbledhje
Mjedis për stafin e shërbimit
Nyje hidrosanitare për personelin akademik
Norma m²/për person


Këto të dhëna jepen me detaje në Tabelën 7 në Aneksë dhe mbështeten nga dokumentacioni përkatës (planimetritë) (Evidencë 4.1).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Institucioni ka vendndodhje të përhershme, infrastrukturë fizike dhe mjedise të mjaftueshme për të përmbushur programin “Master profesional” në ‘Psikologji shkollore’</p> <p>Të gjitha mjediset e institucionit janë tërësisht në funksion të programit dhe garantojnë vijueshmëri të plotë pa çënuar programin në kohë.</p> <p>Programi përmbush qëllimin dhe objektivat e veta brenda së njëjtës godinë.</p> <p>Fakti që objekti nuk është i marrë me qera, garanton qëndrueshmëri në kuptim që nuk ka arsye të ndërpritet programi.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje</p>	<p>Gjatë vizitës, konstatoam që kishte përmirësime të dukshme në aspektin e literaturës në funksion të programit.</p> <p>Biblioteka ishte pasuruar në tituj të ri akademike dhe metodologjike enkas në funksion të programit {gjithsej 12} kjo dhe si një detyrim që akreditimi i mëparshëm e kishte theksuar.</p> <p>Biblioteka kishte dhe shumë tituj on-line, të cilët siç doli nga bashkëbisedimi me studentët, ndiqej nga disa prej tyre.</p> <p>Zyra e financës e institucionit na informoi për shpenzimet në funksion të blerjeve të literaturës të cilat për vitin akademik përkatës kapin shifrën 15.159 lek.</p>

me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.	
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Vizita në institucion na rikonfirmoi se ka në mjaftueshmëri salla leksionesh, mjedise fizike, infrastrukturë teknologjike për të informuar studentët dhe jo vetëm rreth tërësisë së intresave të tyre lidhur me programin.</p> <p>Mjediset ku zhvillohen leksionet janë në hapësirat e nevojshme për numër studentësh dhe kanë ajrosjen e nevojshme për të përmbushur në mënyrë të shëndetëshme të nxënët.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>GVJ konstatoi që kishte përmirësime të dukshme në aspektin e literaturës në funksion të programit. Biblioteka ishte pasuruar në tituj të ri akademike dhe metodologjike enkas në funksion të programit {gjithsej 12} kjo dhe si një detyrim që akreditimi i mëparshëm e kishte theksuar. Mjediset ku zhvillohen leksionet janë në hapësirat e nevojshme për numër studentësh dhe kanë ajrosjen e nevojshme për të përmbushur në mënyrë të shëndetëshme proceset e të nxënët.</p>	



5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Burimi i vetëm i financimit i deklaruar nga UP "Albanian University" përfshin tarifën e shkollimit të paguar nga studentët. Institucioni deklaron se ky burim është i mjaftueshëm për të përballuar kostot e shërbimit për studentët, si dhe qeranë e mjediseve, mirëmbajtjen e godinës, apo pagat dhe sigurimet e stafit. Studentët e programit specifik të studimit kanë kosto më të ulët në krahasim me programet e tjera (psh. Stomatologji) konsideruar se nuk përdoren laboratorë, aparatura, apo bazë materiale.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

Raporti i vlerësimit të brendshëm deklaron pagesën e tarifës së shkollimit si të vetmin burim financiar (100%). Për vitin 2018 – 2019 paraqiten të ardhurat sipas **Tabelës 8 në Aneksë**.

Në funksion të plotësimit të nevojave të njëjësive mësimore-shkencore e detyrimeve ligjore dhe fiskale të Universitetit si institucion jopublik, UP "Albanian University" ka edhe *Zyrën e Financës* dhe *Zyrën e Auditit të Brendshëm* [Evidencë 1.2, neni 13, fq.6].

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Raporti i GVB dhe Institucioni nuk paraqiten të dhëna konkrete me shifra në lidhje me shpenzimet për studentët apo koston e studimit për student dhe për vit akademik.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifën e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Raporti i GVB deklaron se një raport auditimi i brendshëm hartohet çdo vit, për të pasqyruar të ardhurat dhe shpenzimet e institucionit, si dhe bilancin vjetor. UP "Albanian University" deklaron se tarifën e studentëve janë i vetmi burim i ardhurash i cili përdoret në funksion të realizimit të programeve të studimit. Konstatohet se ka mospërputhje mes të ardhurave vjetore të deklaruara në Raportin e GVB dhe ato të marra nga Zyra e Financave gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu ka mospërputhje mes tarifës së shkollimit të deklaruar në Raport (800 Euro) dhe tarifës së deklaruar gjatë vizitave në institucion (1500 Euro)
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	


Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.

Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

Raporti i GVB nuk ka paraqitur të dhëna mbi kostot e realizimit të programit “Master profesional” në “Psikologji shkollore”.

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ konstatoi se raporti i GVB nuk ka paraqitur të dhëna mbi kostot e realizimit të programit “Master profesional” në “Psikologji shkollore”. **Por edhe gjatë bashkëbisedimit të qëllimtë rreth kësaj problematike nuk morëm asnjë informacion gojor apo të shkruar.**



6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është ngritur me Vendim të Senatit Akademik nr. 178 dt.23/07/2010, por që prej vitit 2016 kjo njësi funksionon edhe në nivel departamenti (Vendim Senati Akademik 157/3 dt. 08/09/2016. NJSBC vlerëson procesin mësimor, përmes anketimit/fokus grupeve me studentët, performancën e stafit akademik përmes raporteve të vetë-vlerësimit, cilësinë e programeve mësimore, përfshi përmbajtjen, literaturën apo format e vlerësimit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

Anketimet e NJSBC janë semestrale (dy herë në vit). Të dhënat nga raporti i fundit tregojnë se 70% e studentëve (23/33) kanë marrë pjesë në anketim. Aspektet që paraqiten si problematike përfshijnë: nevojën për më tepër raste/elementë praktikë në orë të mësimit si dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

NJSBC harton raporte semestrale dhe vjetore ku vlerëson procesin mësimor, përmes anketimit/fokus grupeve me studentët, performancën e stafit akademik përmes raporteve të vetë-vlerësimit, cilësinë e programeve mësimore përfshi përmbajtjen, literaturën apo format e vlerësimit. Metodologjia e vlerësimit përfshin anketimet, fokus grupet, dhe raportet e vetë-vlerësimit.


Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Brënda Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme, ndodhet grupi i sigurimit të cilësisë, i përbërë nga dy pedagogë të brendshëm, me gradën Doktor Shkencash. Ky grup siguron ruajtjen e cilësisë në nivel departamenti, duke punuar mbi kurrikulat dhe syllabuset (psh., riorganizimi i programit MP Psikologji Shkollore nga 90 ECTS në 60 ECTS).

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Raportet e NJSBC për 3 vitet e fundit (të shqyrtuara) përfshijnë vlerësimin e disa dimensioneve si mësimdhënia, programet e studimit, stafi akademik, arritjet e studentëve, veprimtaria kërkimore shkencore si dhe analiza SËOT. Rezultatet prezantohen dhe diskutohen në nivel Rektorati.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike




Raporti vjetor i NJSBC së bashku me sugjerimet për përmirësim paraqiten me shkresë të veçantë pranë Rektoratit. Gjatë vizitës në institucion, NJSBC paraqiti si shembull prodhimin e një booklet me rezultatet e anketimit të stafit, i cili u krye për herë të parë këtë vit akademik.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

1. Booklet me rezultatet e anketimit të stafit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; 	<p>NJSBC harton raporte semestrale dhe vjetore ku vlerëson procesin mësimor, përmes anketimit/fokus grupeve me studentët, performancën e stafit akademik përmes raporteve të vetë-vlerësimit, cilësinë e programeve mësimore përfshi përmbajtjen, literaturën apo format e vlerësimit. Raportet janë të aksesueshme online. Metodatat e vlerësimit përfshijnë sondazhet dhe fokus grupet (metoda të tërthorta) si dhe rezultatet e arritura nga studentët me nota dhe pikë, në provime apo detyra kursi (metoda të drejtpërdrejta).</p>



<p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; h. Etj.</p>	
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm; Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Raportet vjetore të NJSBC janë publikuar online dhe janë të aksesueshme për këto. Gjatë vizitës në institucion gjithashtu u vu në dispozicion një booklet me rezultatet e anketimeve të pedagogëve.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecures së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka vënë në dispozicion raportet vjetore 2016-2017 dhe 2017-2018, në të cilat vlerësohet ecuria e programit “Master profesional” në “Psikologji shkollore” dhe gjithashtu sugjerohen forma për përmirësim. GVJ konstatoi se pavarësisht përpjekjeve, ende nuk i kushtohet rëndësia e duhur identifikimit dhe zhvillimit të kompetencave specifike profesionale tek studentët.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë; Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre; Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit; Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to; Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 90, dt. 20/10/2017, AU ka marrë akreditim institucional për një periudhë 2 vjeçare. AU ka institucionalizuar sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, duke pasur një strategji të qartë dhe metoda konkrete për vlerësimin e gjithë elementëve të programeve të studimit. Stafi akademik dhe studentët janë pjesë integrale e procesit të sigurimit të cilësisë përmes përfshirjes në sondazhe, raporte vetëvlerësimi etj. Raportet vjetore të prodhuara janë transparente, publikuar online.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Departamenti ka institucionalizuar sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, duke pasur një strategji të qartë dhe metoda konkrete për vlerësimin e gjithë elementëve të programeve të studimit, përfshi programin “Master profesional” në “Psikologji shkollore”</p> <p><u>Përpjekjet për përmirësimin e programeve të studimit ende nuk janë fokusuar tek kompetencat specifike profesionale që duhet të njohë dhe aplikojë studenti.</u></p> <p>Stafi akademik, studentët janë pjesë integrale e procesit të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë përmes përfshirjes në sondazhe, raporte vetëvlerësimi etj. Raportet vjetore të prodhuara janë transparente, te publikuar online.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Programi “Master profesional” në “Psikologji shkollorë” shtrihet në një vit akademik, organizuar në dy semestre dhe i përkthyer në 60 ECTS nga 90 ECTS që ishte me parë. Programi “Master profesional” në “Psikologji shkollorë”, është i organizuar në 9 module të vlerësuara me 60 kredite (përfshirë temën e diplomës). Numri total i provimeve është 9, pasi parashikohen 8 provime përfundimtare dhe 1 praktikë profesionale. Për t’u diplomuar kërkohet që studenti të ketë realizuar një punim diplome, i cili vlerësohet me 8 kredite, që i përkojnë 200 orë, nga të cilat 16 orë brenda auditorit dhe 184 jashtë tij.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi “Master profesional” në “Psikologji shkollorë” është licensuar në vitin 2013. Qëllimet dhe objektivat e këtij programi shprehen në Rregulloren e Programit të Studimit (Kreu 2, Neni 4, faq. 1-3).

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor


Prej vitit akademik 2018-2019, programi ofrohet me 60 ECTS, me kohezgjatje normale 1 vit akademik/2 semestra.

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Organizimi i programit të studimit referuar detyrimit ligjor dhe rregullores së brendëshme të institucionit. Na rezulton se është në përputhje me strukturën dhe ndarjen në semester dhe javë mësimore.

- 1 vit akademik 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër 5 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore 50 minuta

Programi “Master profesional” në “Psikologji shkollorë”, është i organizuar në 9 module të vlerësuara me 60 kredite (përfshirë temën e diplomës). Numri total i provimeve është 9, pasi parashikohen 8 provime përfundimtare dhe 1 praktikë profesionale. Për t’u diplomuar kërkohet që studenti të ketë realizuar një



punim diplome, i cili vlerësohet me 8 kredite, që i përkojnë 200 orë, nga të cilat 16 orë brenda auditorit dhe 184 jashtë tij.

Praktika profesionale ka si qëllim formimin profesional dhe vënien në provë të aftësive të pjesëmarrësve lidhur me perceptimin praktik të njohurive teorike të përfituara gjatë programit dhe vlerësohet me 6 kredite, të cilave i korrespondojnë 120 orë në auditor dhe 30 jashtë tij.

Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese të programit të studimit “Master profesional” në “Psikologji shkollorë” janë të organizuara në 5 kategori, nga A deri tek E. Gjatë semestrit të dytë të studimeve, studenti përgatit edhe temën e diplomës, mbrojtja e së cilës është kusht i domosdoshëm për diplomim. Ky program përmban 6 ECTS në kategorinë e disiplinave të formimit të përgjithshëm bazë (A); 24 ECTS në kategorinë e disiplinave karakterizuese (B); 16 ECTS në kategorinë e disiplinave integruese (C); 6 ECTS parashikohen për praktikën profesionale(D) dhe 8 ECTS për punimin e tezës së diplomës(E)(Evidencë 1.1, Kreu II, neni 6).

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- | | |
|------------------------------|--|
| ▪ Për leksionet | 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret | 7.5 orë në auditor dhe 17.5 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Ushtrimet | 15 orë në auditor dhe 10 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Detyrë/Projekt | 2 orë në auditor dhe 23 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 20 orë në auditor dhe 5 orë punë e pavarur e studentit |

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Programi është riorganizuar nga 90 ECTS në 60 ECTS në përputhje me ligjin 80/15, dhe ndryshimet përkatëse janë reflektuar në planet mësimore.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Emërtimi i Diplomës për programin e studimit.

“Master profesional” në “Psikologji shkollorë”, shoqëruar dhe me suplementin e diplomës konform detyrimit ligjor, në dy gjuhë shqip/anglisht.

Silabuset:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda. Rezulton të jetë organizuar konform detyrimit ligjit dhe në 60ECTS
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën-Ok
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit.-Ok
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës-?
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë-Ok
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik-Ok
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS.-Ok
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre.-OK
- Format e vlerësimit të studentëve.-Ok

- Detyrimet e studentit për lëndën.-Ok
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse.-Ok

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset janë ndërtuar sipas një standardi të unifikuar, duke përfshirë gjithë rubrikat e nevojshme. Koka e syllabusit përfshin titullin e modulit, lektorin, numrin e krediteve, semestrin, tipologjinë. Gjithashtu tematikat shpjegohen për të 15 javët mësimore, dhe përcaktohet literatura për cdo javë. Format e mësimdhënies, seminarët, detyrat dhe mënyra e vlerësimit gjithashtu përcaktohen në syllabus (edhe format e vlerësimit ndarë në %). Gjithashtu syllabuset përfshijnë literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar. Përsa i përket anës përmbajtësore, titujt e disa prej moduleve realisht nuk përfaqësojnë disiplina, por aspekte të ngushta brënda disiplinave, fakt i cili përbën vështirësi në ndërtimin e çështjeve/tematikave të syllabusit. Kjo ka rezultuar në syllabuse të cilat kanë mospërputhje të dukshme mes titullit të modulit dhe përmbajtjes të syllabusit: Psh. Titulli ‘Dimensioni socio-emocional dhe strategjitë për integrim dhe përshtatje’ ndërkohë përmbajtja e syllabusit përshin të gjitha tematikat nga disiplina ‘Psikologji Zhvillimi’. Vërehet gjithashtu se literatura e detyruar përbëhet kryesisht nga leksione të pedagogut, ndërkohë që ajo e rekomanduar kufizohet në 2-3 tekste dhe nuk përfshin në asnjë rast artikull shkencor, as edhe të vetë pedagogut të lëndës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Akreditimi i parë i programit është kryer në vitin 2017 (Vendim Bordi Akreditimi nr.44, dt 19.05.2017. Programi i studimit për vitin akademik 2018-2019 është riorganizuar sipas ligjit 80/15, nga 90 ECTS në 60 ECTS dhe është në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri</p>	<p>Programi “Master profesional” në “Psikologji shkollorë” zgjeron njohuritë e fituara nga studentët në nivelin Bachelor, duke theksuar më tepër aftësimin e tyre praktik në profesion. Studentët që ndjekin këtë program mund të punësohen si psikologë shkollorë në institucionet e arsimit parauniversitar ose psikologë në OJF të ndryshme.Referuar kriterit 5 programi pajis studentët mjaftueshmërisht me kompetenca profesionale. Gjithsesi GVJ konstatoi se kurrikula nuk përmban lëndën e Metodave të Kërkimit, pavarësisht se në përfundim, studentëve u kërkohet të mbrojnë një temë diplome.</p> <p>Referuar kriterit 7 programi ka objektiva të qarta, e të justifikueshme.</p>

<p>të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Objektivat e programit të shprehur në Rregulloren përkatëse janë në përputhje me nivelin e studimit (zgjerim dhe thellim njohurish) si dhe reflektojnë karakterin profesional të programit përkatës (fokus mbi aftësimin praktik të studentit).</p> <p>Format e kontrollit të njohurive nuk kufizohen tek provimet (i ndërmjetëm, përfundimtar) por përfshijnë detyrat e kursit dhe aktivizimin nëpër seminare.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disa vjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislaionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Pavarësisht përpjekjeve për të arritur dimensione ndërkombëtare (format e mësimdhënies, format e vlerësimit), konstatohet se programi i studimit mbetet brënda kufijve të arsimit universitar shqiptar, në konceptimin e syllabusit dhe në llojin e literaturës së shfrytëzuar. Kështu syllabuset përfshijnë kryesisht botime të autorëve shqiptarë, mungojnë artikuj shkencorë të fushës, si dhe mungon një lidhje e qartë mes mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore shkencore të pedagogut.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin</p>	<p>Programi synon kryesisht aftësimin profesional të studentëve. Programi nuk përmban lëndë ‘Metoda kërkimi’ duke e zhvendosur fokusin nga kërkimi shkencor</p>

shkencor; Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim; Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve; Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.	drejt aftësimit profesional.
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	Megjithëse mungon një studim i mirëfilltë tregu nga institucioni përkatës, nevoja për psikologë shkollorë doli dukshëm edhe gjatë bisedave me studentët, psh. studentët e punësuar si psikologë shkollorë raportuan se mbulonin 2-3 shkolla.
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar; Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.	Institucioni ka kryer një analizë të tregut të punës, si një përpjekje e parë për të kuptuar nevojat e tregut të punës. Në RBV theksohet se kjo analizë ka mjaft mangësi sepse është larg një studimi të mirëfilltë. Gjithsesi analiza jep disa indikatorë mbi nevojat reale të tregut të punës për psikologë shkollorë.
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtar; Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	Ky program studimi synon të prodhojë profesionistë të cilët kontribuojnë në mirëqënien psikosociale dhe emocionale të fëmijëve dhe adoleshentëve.
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	
Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	
Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	Për vitin akademik 2018-2019, Programi “Master profesional” në “Psikologji shkollorë” realizohet me 60 ECTS, dhe përfundon brenda një viti akademik.

<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Pedagogët dhe studentët konfirmuan se informacioni në lidhje me programin e studimit dhe syllabuset e lëndëve u është vënë në dispozicion nga departamenti si dhe pedagogët përgjegjës për modulet përkatëse.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Pas riorganizimit të programit nga 90 ECTS në 60 ECTS, tema e Diplomës mbart peshën e 8 krediteve.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>GVJ konstaton se kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Pas riorganizimit të programit nga 90 ECTS në 60 ECTS, tema e Diplomës mbart peshën e 8 krediteve.</p> <p>Objektivat e programit të shprehur në Rregulloren përkatëse janë në përputhje me nivelin e studimit (zgjerim dhe thellim njohurish) si dhe reflektojnë karakterin profesional të programit përkatës (fokus mbi aftësimin praktik të studentit). Syllabuset respektojnë një strukturë të unifikuar duke përfshirë të gjithë elementët e nevojshëm por kanë mangësi përmbajtësore si dhe në cilësinë e literaturës së përdorur.</p> <p>Kurrikula nuk përmban lëndën e Metodave të Kërkimit, pavarësisht se në fund studentëve u kërkohet të mbrojnë një temë diplome.</p> <p>Pavarësisht përpjekjeve për të arritur dimensione ndërkombëtare, konstatohet se programi i studimit mbetet brënda kufijve të arsimit universitar shqiptar, në konceptimin e syllabusit dhe në llojin e literaturës së shfrytëzuar.</p>	



8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Mësimdhënia zhvillohet në 2 semestra, secili i organizuar në 15 javë mësimore. Format e mësimdhënies përfshijnë leksionet dhe seminarat, ndërkohë që kontrolli i njohurive kryhet përmes provimeve (i ndërmjetëm dhe përfundimtar), detyrave të kursit, dhe pjesëmarrjes në seminare. Vlerësimi bëhet me pikë (0-100) dhe rezultati nga të gjithë komponentët e vlerësimit konvertohet përfundimisht në notë, nga 4-10. Cilësia e mësimdhënies vlerësohet periodikisht nga studentët të cilët plotësojnë sondazhe dhe gjithashtu marrin pjesë në fokus grupe. Rezultatet e sondazheve dhe fokus grupeve bëhen publike si në raportin e NJSBC ashtu edhe në raportin vjetor të Departamentit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Detyre
- Praktikë profesionale

Format e kontrollit të njohurive

Njohuritë në lëndë vlerësohen përmes katër komponentëve përfshi a. Pjesëmarrje aktive në seminar (10%); b. Detyra kursi/ese/punë grupi (10%); c. Provimi i ndërmjetëm (20%); d. Provimi përfundimtar (60%). Në përmbyllje të studimeve, studentët mbrojnë temë diplome, pavarësisht se nuk zhvillojnë një lëndë Metoda Kërkimi. Për këtë arsye, si dhe duke marrë parasysh natyrën e programit (Master Profesional) sugjerohet mundësia e aplikimit të një forme alternative ndaj temës së diplomës (psh. "Dosje me raste studimore).

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Ky informacion nuk është dhënë në RVB, dhe institucioni nuk e disponon në formë zyrtare. Por studentët u shprehën se kanë marrë pjesë në leksione të hapura apo tavolina të rrumbullakta mbi tematika që lidhen me fushën e tyre të studimit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Procedurat e pranimit të studentëve shpjegohen nga Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentit. Që në kontaktet e para studentët informohen në lidhje me kriteret dhe dokumentacionin që duhet të paraqesin. Kriteret për pranimin në Programin “Master profesional” përshijnë Diplomën “Bachelor” me 180 ECTS, plotësimin e kriterëve akademike të vendosura nga Departamenti si dhe pagesën e tarifës vjetore. Në vitin aktual akademik janë rregjistruar 33 studentë, për herë të parë në vit të parë me notë mesatare hyrëse 6.7. Në vitin akademik 2017-2018 janë rregjistruar 42 studentë, me notë mesatare në hyrje 7.09. Zyra e Alumnit mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, duke i përfshirë ata në aktivitete të ndryshme të institucionit.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Një student pranohet të ndjekë programin “Master profesional” në “Psikologji e Përgjithshme” nëse ka Diplomë Bachelor me 180ECTS (diplomë e ekuivalentuar nga MASR nëse e fituar jashtë Shqipërisë), plotëson kriteret e vendosura nga komisioni i pranimit, dhe paguan tarifën e shkollimit.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Në vitin akademik 2013-2014 janë rregjistruar 9 studentë me notë mesatare në hyrje 6.77, dhe notë mesatare në dalje 8.9. Në vitin akademik 2017-2018 janë rregjistruar 42 studentë me notë mesatare në hyrje 7.09. Në vitin 2018-2019 janë rregjistruar 33 studentë me notë mesatare hyrëse 6.7.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Ky program ka 33 studentë të regjistruar aktualisht në vitin e parë për herë të parë, me notë mesatare hyrëse 6.7.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare


Gjatë vizitave në institucion u informuam se studentët e vitit akademik 2017-2018 diplomohen në muajin prill. Numri i tyre është 38.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

N/A

Të dhëna për punësimin e studentëve

Numri total të diplomuarve



Nga viti 2013 deri në 2018 në total janë regjistruar 173 studentë. Në vitin akademik 2013-2014 janë regjistruar 9 studentë. Numri i studentëve në dalje është 8, ndërsa mesatarja dalje e tyre është 8.9.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Studimi i tregut të punës realizuar nga Institucioni në mënyrë specifike për Programin “Master profesional” në “Psikologji shkollorë” raporton se **64.5% e studentëve janë punësuar në përputhje me Diplomën**. Ndërkohë gjatë vizitave në institucion u vërejt se zyra e Alumni nuk disponon shifra të sakta mbi numrin total të të punësuarve. Vihet në pikëpyetje mënyra sesi janë nxjerrë përqindjet në dokumentin specifik si dhe besueshmëria e tyre.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Analiza e tregut të punës realizuar nga Institucioni në mënyrë specifike për Programin “Master profesional” në “Psikologji shkollorë” raporton se **60.46% e studentëve janë punësuar në jo përputhje me Diplomën**. Ndërkohë gjatë vizitave në institucion u vërejt se zyra e Alumni nuk disponon shifra të sakta mbi numrin total të të punësuarve. Vihet në pikëpyetje mënyra sesi janë nxjerrë përqindjet në dokumentin specifik si dhe besueshmëria e tyre.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të</p>	<p>Nga kontrolli i dosjeve të studentëve u konstatua se ato përmbajnë dokumentacionin e plotë për pranim në ciklin e dytë të studimeve (përfshi diplomën Bachelor me 180 ECTS, dhe dokumentacionin e kërkuar nga institucioni). Studentët e “Master profesional” në “Psikologji shkollorë” para diplomimit japin gjithashtu provimin e gjuhës angleze në nivel B2.</p>

<p>studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.</p>	
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve; Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion; Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Studentët u shprehën se institucioni organizon sesione informuese (open days) si dhe vë në dispozicion të studentëve Manualin e Studentit, ku përfshihet gjithë informacioni në lidhje me statusin e institucionit si dhe programit specifik të studimit. Gjithashtu Zyra e Koordinimit dhe Mbështjetjes ndaj Studentëve dhe Zyra e Alumnit angazhohen efektivisht në këshillimin e karrierës së studentëve, duke ju dhënë gjithashtu informacion për mundësitë e punësimit.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar; Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik; Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Pas vizitës në Sekretarinë Mësimore u konstatua se Institucioni mban të dhëna të sakta për studentët në Regjistrin Themeltar, Regjistrin e Diplomave dhe atë të Arritjeve Akademike. Numri total i të diplomuarve në "Master profesional: në "Psikologji shkollore" është 87 (Regjistri i Diplomave). Numri i studentëve të regjistruar aktualisht është 33. Kontrolli i Regjistrit të Arritjeve Akademike tregoi se Institucioni mban të dhëna për ecurinë akademike të studentëve nga regjistrimi i tyre.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre; Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p><u>Gjatë vizitës në institucion nuk morëm një përgjigje as gojore dhe as të dokumentuar për një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas mbarimit të studimeve.</u></p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit; Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p>	<p>Studentët u shprehën se institucioni organizon sesione informuese (open days) si dhe vë në dispozicion të studentëve Manualin e Studentit, ku përfshihet gjithë informacioni në lidhje me statusin e institucionit si dhe programit specifik të studimit. Studentët informohen për procesin</p>

<p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>e vlerësimit dhe rezultatet përkatëse të cilat mund të diskutohen me pedagogët përkatës.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentit kryen funksionin e saj në ofrimin e këshillimit për studentët si dhe facilitimin e kontakteve me institucionet ku kryhen praktikat.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>GVJ konstatoi se dosjet e studentëve përmbajnë dokumentacionin e plotë për pranim në ciklin e dytë të studimeve (përfshi diplomën Bachelor me 180 ECTS, dhe dokumentacionin e kërkuar nga institucioni).</p> <p>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentit kryen funksionin e saj në ofrimin e këshillimit për studentët si dhe lehtësimin e kontakteve me institucionet ku kryhen praktikat.</p> <p>Institucioni nuk disponon statistika të krejt të sakta për numrin e të punësuarve pas diplomimit.</p>	



KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Format e kërkimit shkencor në AU, përfshijnë veprimtari si: konferenca apo simpoziume/tavolina të rrumbullakta, organizuar në rang departamenti apo universiteti, trajnime të qëllimta, si dhe botime në revistën shkencore "Optima". Veprimtaritë shkencore përgjithësisht kanë karakter lokal, si dhe botimet mbeten kryesisht brënda kufijve kombëtarë. Gjithsesi, fushat e botimeve të pedagogëve i ushqejnë lëndët përkatëse, duke kryer lidhjen e kërkimit me mësimdhënien. Dy dimensione ende të pashkelura janë ndërkombëtarizimi i kërkimit shkencor të institucionit në përgjithësi dhe i Departamentit të Psikologjisë ku përmbushet programi MP dhe pjesëmarrja në projekte aplikative apo kërkimore-shkencore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (Ploteso Tabelat ne aneks)

Raportohen 8 aktivitete shkencore të organizuara nga IAL për vitin akademik 2018-2019 si dhe një numër total prej 63 botimesh nga personeli akademik i IAL. Nuk ka një ndarje të qartë përsa i përket personelit akademik specifikisht të angazhuar në programin "Master profesional" në "Psikologji shkollore".

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse; Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	U konstatua se publikimet e personelit akademik janë kryesisht brënda vendit, konferenca shkencore të universitetit, apo Revista e publikuar nga po ky institucion "Optime". Nga vetëraportimet e pedagogëve u konstatua se ka një numër shumë të vogël botimesh të e mirëfillta shkencore me ISSN. Gjithsesi tematikat e trajtuara kanë karakter aplikativ përsa i përket shërbimit psikologjik në grupe të caktuara, psh., tematika si 'Crrregullimet e të nxënësve', 'Bullizmi në shkollë', etj.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Institucioni nuk ofron programe mësimdhënie në gjuhë të huaj.</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>U konstatua se vetë institucioni nuk organizon programe specifike të mirëfillta për kualifikimin profesional të stafit. Gjithsesi institucioni nxit dhe lehtëson stafin akademik i cili kërkon kualifikime të mëtejshme jashtë vendit (psh.,u përmendën gjatë vizitës në institucion raste të pedagogëve që ndjekin studime doktorale jashtë vendit.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni disponon format specifik për vetë-raportimin e aktivitetit kërkimor shkencor nga pedagogët. Gjithsesi këto të dhëna nuk janë përpunuar në nivelin e krijimit të një databaze institucionale për botimet shkencore.</p> <p>Gjithashtu mungon baza e të dhënave për projektet kërkimore shkencore cka është e pritshme duke qenë se numri i këtyre projekteve është minimal apo inekzistent (konstatohet si pikë e dobët tek RVB).</p> <p>Dy nga stafet e angazhuara në program kanë qendra shërbimi psikologjik si iniciativa private, gjë që “redukon” interesat e tyre për të inicuar projekte brenda programit; ata mjaftohen në cilësinë dhe korrektesën me të cilën përbushin mësimdhënien.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>GVJ konstatoi se institucioni disponon format specifik për vetë-raportimin e aktivitetit kërkimor shkencor nga pedagogët. Por, këto të dhëna nuk janë përpunuar në nivelin e krijimit të një databaze institucionale për botimet shkencore.</p> <p>Numri i projekteve të inicuar nga stafi është minimal dhe nuk mund të konsiderohet si burim të ardhurash për programin. Gjithashtu mungon baza e të dhënave për projektet kërkimore inicuar nga programi.</p> <p>Institucioni lehtëson stafin akademik i cili kërkon kualifikime të mëtejshme jashtë vendit, por nga zyra e financës nuk rezultojnë mbështetje financiare qoftë dhe modeste.</p> <p>Veprimtaritë shkencore në të cilat angazhohet stafi përgjithësisht kanë karakter lokal (botime në Revistën Optime, apo konferenca të organizuara nga vetë universiteti), si dhe botimet mbeten kryesisht brënda kufijve kombëtarë, dhe pa ISSN.</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

UP "Albanian University", specifikisht stafi akademik i departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme ku funksionon programi, bashkëpunon me institucione të tjera të ngjashme në nivel lokal dhe kombëtar. Ekzistojnë disa marrëveshje me institucionet e tjera brënda vendit, marrëveshje të cilat formalisht priren drejtë praktikave profesionale, më shumë se sa drejt kërkimit. Institucioni ka të dhëna rreth veprimtarive si: konferenca, simpoziume, leksione të hapura, promovime botimesh. Në nivel departamenti raportohen 27 marrëveshje në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, por, marrëveshjet aktive janë relativisht modeste.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (ploteso Tabelat ne aneks)**
Raportohet se numri i pjesëmarrjeve në projekte kombëtare është 4, ndërkohë që nuk ka evidencë për përfshirje të lektorëve të huaj, trajnime jashtë vendit apo mobilitet të studentëve.
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese; Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	Në bazë të të dhënave të grumbulluara u konstatua se për programin specifik të studimit Departamenti ka marrëveshje për zhvillimin e praktikave profesionale me disa institucione, si Qendra Sociale 'Të qëndrojmë sëbashku' apo 'Njerëzit në ndihmë të njerëzve', "Shtëpi e Kuqe", etj. Gjatë vizitës në institucion u paraqitën të dhënat për 5 marrëveshje institucionale të nënshkruara në muajin Mars, të cilat do të lehtësonin zhvillimin e praktikave profesionale. U konstatua se marrëveshjet ishin në terma të përgjithshëm, dhe impakti i tyre nuk është konkretizuar ende.
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit; Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së	U konstatua se niveli i bashkëpunimit mes personelit akademik dhe atij administrativ ishte mjaft i mirë. Ndarja e detyrave dhe shkëmbimi i informacionit në dobi të procesit dukshëm ishte i qartë.

vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione {DAR} për të lehtësuar kryerjen e praktikave profesionale për studentët e këtij programi studimi.</p> <p>Marrëveshjet datojnë të jenë të muajit mars 2019 ku pritet të shikohet impakti në perspektive.</p> <p>Gjithsesi, ende nuk konstatuam se është “pjekur” mendimi për një sistem mentorësh që do të udhëheqin praktikën profesionale në institucionet me të cilat është marrëveshja.</p> <p>Marrëdhëniet me institucionet homologe jashtë vendit janë në zhvillim e sipër (psh. përmenden si shembuj universitetet në Kosovë ose Itali), sikundër gjithashtu mungon dhe një analizë e benefiteve të institucionit nga këto marrëveshje.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>GVJ konstatoi se institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione {DAR} për të lehtësuar kryerjen e praktikave profesionale për studentët e këtij programi studimi por këto marrëveshje nuk kanë terma specifikë dhe nuk është ende i dukshëm impakti mbi cilësinë e programit. Nuk është “pjekur” ende, mendimi për një “sistem mentorësh” që do të udhëheqin praktikën profesionale në institucionet ku studentët përmbushin këtë pjesë të programit dhe ku repertori sjellor i studentit rritet deri në nivelin e kompetencave profesionale.</p> <p>Marrëveshjet janë kryesisht me aktorë lokal dhe shtrihen në nivel kombëtar; përpjekjet për marrëveshje me institucione ndërkombëtare janë ende modeste.</p>	



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Në përfundim të procesit të vlerësimit kostatojmë se:

Vizitat e planifikuara në Insitucionin UP “Albanian University” në datat 15-16 prill, 2019, GVJ, nga eksperte Prof.As.Dr. Marjana Sinani, Prof.As.Dr. Erika Melonashi, përmbushën objektivat e vizitës konform procedurave të miratuara për akreditim. Vizitat në mjediset fizike, takimet e punës sipas planifikimit të paracaktuar nga stafi i ASCAL. Vizita në Institucion u përmbush konform një protokolli të përcaktuar dhe miratuar nga dy institucionet respektive.

Qëllimet e GVJ, u bënë të hapura në praninë e strukturave të Institucionit. Përgjatë vizitës, gjetëm mirëkuptimi në funksion të së mirës së përbashkët që e synojnë të dy institucionet respektive dhe që është “cilësia” dhe “standardi” në proces dhe në përmblyje të programit.

Konstatojmë që: stafi akademik edhe personeli, përfshirë të gjitha nivelet dhe strukturat që nga institucioni i Rektori, Dekanit, Përgjegjesit të Departamentit, përgjegjësit të zyrës së personelit dhe të kurrikulave, përfaqësues të studentëve, përcollën përgjegjëshmëri institucionale, kompetencë, dhe sjellje etike.

Për rekomandimin a), ‘Të plotësohet rregjistri i arritjeve me vlerësimet negative të studentëve’, u konstatua se **Institucioni e ka përmbushur pjesërisht këtë rekomandim.**

Për rekomandimin b), ‘Të shtohet numri i titujve në Bibliotekë lidhur me psikologjinë dhe të përmirësohet infrastruktura’ u konstatua se **Institucioni e ka përmbushur kryesisht këtë rekomandim.**

Për rekomandimin c), ‘Të mundësohet informimi i studentëve, stafit dhe publikut lidhur me sigurimin e cilësisë’ u konstatua se **Institucioni e ka përmbushur këtë rekomandim.**

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

Si grup i VJ, konstatojmë që:

- Përgjithësisht egziston përputhje e RVB me konstatimet që u bënë gjatë hulumtimit të Raportit të brendshëm dhe gjatë vizitës së zhvilluar në institucion.
- Programi “Master profesional” në “Psikologji shkollorë” përgjithësisht ngrihet mbi programin “Bachelor” në “Psikologji”, program që funksionon brenda Institucionit, dhe, merr në konsideratë parimin e koherencës horizontale dhe vertikale mbi të cilin ndërtohet një program “Master profesional”.

a) Pika të forta:

- 1) Programi është hartuar në respekt dhe konform modeleve përgjithësisht të konfirmuara me programet simoter. Programi vjen i balancuar në raport me lëndet e përgjithshme, karakterizuese, integruese dhe praktika profesionale.

- 2) Programi i studimit është në rezonancë me nevojat e tregut. Identifikimi dhe konfirmimi i Psikologut shkollor si profesion i rregulluar, është konsideruar mjaftueshëm seriozisht nga institucioni.
- 3) Studentët. Rreth 50% e studentëve në program janë të punësuar, pjesa më e madhe në profesionin e psikologut. Ky fakt rezulton si pikë e fortë, pasi, cilësinë e programit shpesh e diktojnë dhe interesat që paraqesin studentët referuar rasteve dhe përvojave që sjellin në auditor, përshkak të të qenit të punësuar.
- 4) Stafit akademik i brendshëm dhe i jashtëm paraqitet në nivel mjaftueshmërisht të përgatitur, referuar faktit që 5 prej tyre janë me formim adekuat referuar disiplinave që zhvillojnë, si dhe faktit që punojnë në të njëjtin institucion në një hapësirë kohore më shumë se 5 vite akademike, kohë e nevojshme për tu konsoliduar në mësimdhënie.
- 5) Vlerësimi i brendshëm i programit bëhet periodik dhe referuar instrumenteve specifike që kërkon procesi i vlerësimit dhe në pajtim të plotë me parimet etike dhe konfidencialitetin.

b) Pika të dobëta:

- 1) Stafit akademik i angazhuar në program, nuk inicon procese profesionale dhe ekspertizë që gjenerojnë të ardhura për programin.
- 2) Studentët nuk janë mjaftueshëm të njohur me kompetencat profesionale që duhet të përvetësojnë si psikologë shkollorë
- 3) Praktika profesionale nuk është ende e rregulluar mbi marrveshje specifike dhe në terma specifike. Egzistojnë rreth pesë marrëveshje të nënshkruara në muajin mars 2019, të cilat ende nuk kanë dhënë impakt në cilësinë e programit.
- 4) Mendimi akademik/literar në fushën e shërbimit psikologjik nuk është mjaftueshëm i përfaqësuar në botime me ISSN. Institucioni ka vetëm një botim "OPTIME", ku hapësira për botime është e reduktuar qoftë dhe për faktin që ky periodik shkencor mbulon të gjitha fakultetet.
- 5) Pavarësisht strukturës së unifikuar formale, disa prej syllabuseve kanë mangësi kryesisht në konceptimin e përmbajtjes (reflektim i drejtpërdrejtë i mënyrës së formulimit të titujve të moduleve) dhe llojin/cilësinë e literaturës së përdorur (kryesisht leksione të pedagogëve apo libra shqip, botime relativisht të vjetra).
- 6) Përfshirja në projekte aplikative që lidhen me fushën e studimit (kombëtare/ndërkombëtare) nga ana e stafit akademik apo studentëve është minimale.
- 7) Ka mospërputhje mes njohurive që ofron programi dhe kritereve që studentët duhet të plotësojnë për diplomim, psh., studentët mbrojnë temë diplome por kurrikula nuk përmban lëndën e Metodave të Kërkimit.

c) Mundësitë:

- 1) Profesionin e Psikologut shkollor është në listën e profesioneve të rregulluara, çka e rrit konkurueshmërinë në treg nga njëra anë, por, stimulon cilësinë nga ana tjetër.
- 2) Egziston Rrjeti i institucioneve Albanian College. Ky fakt potencon prurje të studentëve cilësor, por, dhe potencon hapësira për praktika të mirë-mentuara profesionale.
- 3) Ka një sërë institucionesh ndërkombëtare me profil të spikatur në përgatitjen e psikologut shkollor me të cilat institucioni mund të krijojë marrëveshje bashkëpunimi në të ardhmen.

d) Pengesat:

- 1) Institucionet shkollore ende nuk janë mjaftueshëm të gatshme ta asistojnë psikologun shkollor dhe shërbimin që ky profesion kryen.
- 2) Egzistojnë programe “Master profesional” në “Psikologji shkollore” në më shumë se disa universitete në gjithë vendin.

Rekomandime:

Sygjerojmë institucionin, më drejtpërdrejtë Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme që të planifikojë:

- 1) Rregullimin e praktikave profesionale përmes marrëveshjeve specifike në terma specifike, referuar, sistemit të mentorëve dhe formateve mbi të cilën mentorët e përcjellin punën e tyre.
- 2) Të shihet mundësia për të përkthyer në {kompetenca profesionale} çdo syllabus.
- 3) Inicimin e një botimi ISSN që të ketë fokus psikologjinë dhe shërbimet socio-psikologjike
- 4) Të rishihet mundësia për të bërë mbrojtjen e diplomës përmes “Dosjes” ku dokumentohen “rastet e studimit” që studenti/ja ka ndjekur, identifikuar, zgjidhur, përfunduar gjatë programit në një vit akademik.
- 5) Rishikimin e syllabuseve sidomos në aspektin e organizimit dhe formulimit të tematikave, përfshirjes së literaturës më të fundit bashkëkohore (kombëtare dhe ndërkombëtare) dhe përfshirjes së ekspertizës kërkimore/botimeve shkencore të pedagogëve në to.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Prof. As. Dr. Mariana Sinani
2. Prof. As. Dr. Erika Melonashi

SUMMARY ANALYSIS FOR THE EVALUATION OF THE STUDY PROGRAM

I. SUMMARY ANALYSIS OF FULFILLMENT OF RECOMMENDATIONS FROM THE FIRST ACCREDITATION

1. For recommendation a), 'To include in the register of academic results, negative evaluations of students' the recommendation was partially met by the institution
2. For recommendation b), 'To increase the number of psychology books in the library and improve infrastructure' the recommendation was substantially met by the institution.
3. For recommendation c), 'To inform students, staff and the public on quality assurance' the recommendation was fully met by the institution.


II. SUMMARY ANALYSIS OF THE RVJ BY SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).

a. Strengths:

1. The study program is in line with similar existing programs. Also it reflects a balanced structure including general subjects, subjects characteristic of the program, integrative modules as well as professional practice.
2. The study program resonates with the existing demands of the market. The institution demonstrates serious efforts in the definition and promotion of the profession of school psychologist.
3. Approximately 50% of students are also employed, and most of them as psychologists. This fact is considered as an asset, considering the transference of practical experiences and cases to the classroom setting.
4. Full-time and part-time academic staff is professionally qualified. Five of them teach subjects closely related to their specific field of expertise and have been employed at the institution for more than 5 years.
5. There is a periodic internal evaluation of the program using specific procedures and instruments; confidentiality and ethical considerations are followed appropriately.

b. Weaknesses:

1. The academic staff is not involved in any processes or activities which have financial benefits for the programs.
2. Students do not display sufficient awareness of professional competences as school psychologists, which is considered a major drawback in professional programs such as that of school psychologists.



3. Professional practice is not yet standardized in terms of specific institutional agreements. The department reported 5 agreements signed within March, 2019 which have not still produced an actual impact on the quality of the program.

4. Academic publications (ISSN Journals) of staff are very few and insufficient for making an impact on the quality of the program. The Institution has one single journal "OPTIME", which publishes papers from the whole university, resulting in very limited number of articles from the specific department.

5. The unified structure of the syllabi in terms of formatting, does not always reflect a high quality of the content. Some syllabi have problems in the way they are conceptualized (a direct reflection of the module titles) and the type and quality of compulsory or recommended literature (lectures of the staff; books in albanian, or outdated publications).

6. There is a minimal involvement of staff or students in applicative projects (national or international) directly related to the field of study.

7. There is a gap between knowledge and skills provided by the study program on the one hand and obligations that students have to fulfill for graduation, on the other. For instance, although students have to defend a master thesis, they do not attend any Research Methods courses.

c. Opportunities:

1. The school psychologist is a regulated profession in Albania. This fact on the one hand increases competition but on the other hand greatly stimulates quality enhancement of programs.

2. The existence of a network of institutions (Albanian College), provides a good opportunity for supervised professional practices and also serves as a pool for future quality students.

3. The institution could identify and initiate future agreements with several international institutions with a strong profile of School Psychology.

a. Threats:

1. Schools are not sufficiently equipped or willing to assist school psychologists in their specific activities.


2. Several higher education institutions in Albania offer Professional Masters in School Psychology.

Recommendations:

We have the following recommendations for the Department of General Psychology:

1. To regulate Professional Practices through specific institutional agreements, referring to particular aspects including mentorship systems and reporting formats.

2. To reflect on how each syllabus could be linked to specific professional competences



3. To consider the publication of a journal (with ISSN no.) focusing specifically on psychology and psychological services.
4. To consider the alternative possibility of thesis defense with a 'Case Studies Folder', reflecting work accumulated throughout the academic year.
5. To review course syllabi particularly as regards the organization and definition of topics, the inclusion of recent contemporary literature (national and international), and the inclusion of publications from the academic staff.

External Evaluation Group

1. Prof. As. Dr. Mariana Sinani

2. Prof. As. Dr. Erika Melonashi